



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2702, datë 22.12.2016

Për

**“Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe linjat me qira dhe masat përkatëse rregulluese”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Sara Recj, në mbledhjen e datës 22.12.2016, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe linjat me qira dhe masat përkatëse rregulluese”**

Dokumentacioni i Grupit të Punës përbëhet nga:

- Projekt vendimi
- Relacioni Shoqërues i projekt vendimit
- Dokumenti: “Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira – Dokumenti përfundimtar”

## BAZA LIGJORE:

1. Nenet 31 e në vijim i Kreut VI të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*ligji nr. 9918*);
2. Rregullore Nr.9 “Për Analizën e Tregut”, miratuar me VKD nr.747, date 17.07.2009, e ndryshuar;
3. Udhëzues për Procedurat e Keshillimit me Publikun miratuar me VKD nr.1183, datë 10.03.2010.
4. Vendimi KD të AKEP me Nr.2701, datë 22.12.2016 Për “*Miratimin e dokumentit: Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira – Dokumenti Përfundimtar*”

## K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Projekt-vendimi per “*Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg për tregjet me shumicë të aksesit broadband dhe linjat me qira dhe masat përkatëse rregulluese*”
2. Dokumenti: *Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira – Dokumenti përfundimtar*
3. Relacioni shpjegues për Projektvendimin (**Relacioni**)

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

## V Ë R E N:

1. Këshilli Drejtus i AKEP me Vendimin Nr. 2701, datë 22.12.2016, miratoi dokumentin “*Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira – Dokumenti Përfundimtar*”.
2. Dokumenti: “*Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband ne Internet dhe Linjave me Qira – Dokumenti përfundimtar*”:
  - a) është përgatitur pas kryerjes së këshillimit publik të zhvilluar më 15.06-15.08.2016, dhe përmban komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimin e AKEP për komentet (Aneks 1, i dokumentit) në përputhje me nenin 35 të Ligjit 9918;
  - b) përbën një dokument të rëndësishëm rregullator në bazë së të cilit merren vendimet për FNT në tregjet e analizuar dhe masat rregulluese respektive, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimet rregullatore dhe tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri;
  - c) nga pikpamja e rregullsisë, është në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin 9918 dhe Rregulloren për Analizën e tregut;

- d) nga pikpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara për analizen e tregut në nenin 31 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, dhe Rregullores, përfshirë përkufizimin e detajuar të tregjeve përkatëse dhe analizën e testit të tre kritereve, kriteret e përcaktimit FNT, dhe detyrimet e parashikuara për FNT;
  - e) ka marrë në konsideratë rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Europian dhe praktikën më të mirë rregullatore në vendet e Bashkimit Europian, parimet e ligjit të konkurrencës dhe kushtet aktuale të tregut Shqiptar celular;
  - f) vendosja, ndryshimi, mbajtja dhe heqja e detyrimeve për FNT është në përputhje, me përcaktimet e nenit 36 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, me pikën 5 të nenit 3 të Rregullores dhe me objektivat rregullatore të AKEP, të përcaktuara në nenin 7 të ligjit 9918.
3. Dokumenti “*Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband në Internet dhe Linjave me Qira – Dokumenti përfundimtar*” shërben si bazë arsyetuese për marrjen e vendimeve për statusin me FNT në tregjet e analizuar, dhe masat rregulluese për sipërmarrësin Albtelecom sh.a të përcaktuar me status me FNT.

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar më lart, bazuar në pikën 1 të nenin 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar,

## **V E N D O S:**

1. Bazuar në dokumentin “*Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit broadband në Internet dhe Linjave me Qira – Dokumenti përfundimtar*”, miratuar me VKD Nr.2701, datë 22.12.2016, të përcaktojë sipërmarrësin Albtelecom Sh.a., sipërmarrës me FNT në tregjet përkatës të mëposhtme:
  - a. *Tregun me shumicë të aksesit në nivel lokal në vendndodhje fikse (WLA)*
  - b. *Tregun me shumicë të aksesit në nivel qendror për produkte të tregut të përgjithshëm (WCA)*
  - c. *Tregun me shumicë të aksesit me çilesi të lartë në vendndodhje fikse (WHQA);*
2. Zona gjeografike e tregjeve përkatëse me FNT është kombëtare apo territori i Republikës së Shqipërisë dhe dimensionin e plotë të produkteve/shërbimeve të secilit treg përkatës është sipas përcaktimeve të Dokumentit të Analizës së Tregut të miratuar me VKD Nr.2701 datë 22.12.2016.
3. Sipërmarrësi ALBTELECOM sh.a. i përcaktuar sipërmarrës me FNT në **tregun me shumicë të aksesit në nivel lokal në vendndodhje fikse** (pika 1/a me sipër), është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet si më poshtë, por pa u kufizuar:

3.1 *Detyrimin e mosdiskriminimit, sipas nenit 39 te ligjit nr. 9918.*

3.2 *Detyrimin e transparencies, sipas nenit 40 te ligjit nr. 9918.*

3.3 *Detyrimin për akses dhe përdorimin e përbashkët te faciliteteve te rrjetit, sipas nenit 42 te ligjit nr. 9918.*

3.4 *Detyrimin per kontroll te tarifave sipas nenit 45 te ligjit nr. 9918.*

4. Detyrimet e mesiperme ne piken 3, perfshijne midis te tjerave:

4.1. ***Detyrimi i Mosdiskriminimit:***

- Sipermarresi Albtelecom Sh.a., te zbatoje kushte te njejta, ne rrethana te njejta ndaj sipermarresve te tjere, qe ofrojne sherbime ekuivalente, si dhe t'u ofrojne sipermarresve te tjere sherbime dhe informacion ne kushte te njejta dhe me cilesi te njejte, sikunder ai i ofron per sherbimet e veta, per filialet ose partneret e tij;
- Perditesimin e ofertes reference te aksesit ne rrjetin hapur lokal te Albtelecom per aksesin fizik ne LLU ne pershtatje me ndryshimet e bere ne rrjetin perkates, duke kerkuar perditesimin sipas zhvillimeve teknologjike dhe nevojave te tregut dhe aksesin ne rrjetin NGA, brenda 45 diteve nga hyrja ne fuqi e ketij vendimi. Oferta reference duhet te permbaje te gjitha termat dhe kushtet e aksesit ne rrjet, perfshire ato te sherbimeve ndihmese, termat dhe kushtet kryesore kontraktuale, si dhe sherbimet e aksesit ne tubacione ne nivel lokal dhe tarifate, kushtet e perdorimit dhe perfitimit te aksesit te tyre.
- Albtelecom duhet te mos diskriminoje midis operatoreve te ndryshem dhe midis operatoreve te tjere dhe klienteve, filialeve te veta dhe per kete do te kete;
  - *Detyrimin per publikimin e Treguesve Kryesore te Performances (Key Performance Indicators -KPI) per ofrimin aksesit fizik ne rrjetin lokal te hapur;*
  - *Detyrimi per te ofruar marrveshje te Nivelit te Sherbimit (service level agreement-SLA);*
  - *Detyrim per informacion dhe shpjegime te plota, bazuar ne rregullat dhe procedurat e kuadrit ligjor dhe rregullator (Rregullorja e Akses dhe Interkoneksion);*
  - *Detyrimin per percaktimin e kerkesave te arsyeshme dhe publikimin e tyre, si dhe dhenien e arsyeve te refuzimit (ne rast se ka) dhe publikimi e ketyre arsyeve;*
  - *Detyrimin per percaktimin e afatit kohor ne shqyrtimin e kerkeses se arsyeshme dhe realizimin e saj;*

4.2. ***Detyrimi i transparencies:***

4.2.1 Oferta Reference e aksesit ne rrjetin lokal te hapur te Albtelecom (RUO), duhet te perfshije informacionin e meposhtem te nevojshem per aksesin ne rrjetin fiks te Albtelecom ne nivel lokal:

- a) Specifikimet teknike;
- b) Karakteristikate e rrjetit;
- c) Termat dhe kushtet për ofrimin dhe përdorimin e rrjetit lokal te hapur dhe tubave ne nivel lokal;

ç) Tarifat per aksesin ne rrjetin e hapur lokal dhe perdorimin e tubave ne nivel lokal, përfshirë zbritjet e mundshme.

#### 4.3. **Detyrimi per akses dhe perdorimi i perbashket i faciliteteve te rrjetit:**

- t'u ofrojë palëve të treta akses në elemente të veçanta të rrjetit dhe/ose faciliteteve, duke përfshirë akses në elemente të rrjetit, të cilat nuk janë aktive dhe akses të hapur në qarkun lokal;
- te mos anulohet aksesin ne facilitetet, kur e ka dhene ate;
- te negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;
- te ofrojë akses te hapur ne nderfaqet teknike, protokollet ose teknologjite e tjera te rendesishme, te domosdoshme per nderveprimin e sherbimeve ose per sherbimet e rrjetit virtual;
- te ofrojë bashkevendosje ose forma te tjera te perdorimit te perbashket, perfshire ndertesat, tubacionet kabllore ose shtyllat, kullat;
- te krijojë kushtet e nevojshme per te siguruar nderveprimin e sherbimeve pike fundore – pike fundore, duke përfshirë facilitetet per sherbimet e rrjetit inteligjent;
- te ofrojë akses ne sistemet mbeshtetese funksionale ose sistemet e ngjashme informatike (softëare), te nevojshme, per te siguruar konkurrence te ndershme ne ofrimin e sherbimeve;

#### 4.4. **Detyrimi per kontroll te tarifave:**

1. Tarifat e aksesit ne rrjetin lokal te Albtelcom per LLU (te plote dhe te ndare (perbashket), si dhe aksesin ne tuba ne nivel lokal jane objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP.
2. Metoda e rregullimit te tarifave te sherbimeve ne piken 1 me siper percaktohen me vendim te vecante nga AKEP sipas percaktimeve te nenit 57 e ne vijim te Ligjit 9918.

5. Sipermarresi ALBTELECOM sh.a. i përcaktuar sipermarres me FNT ne **tregun me shumice te aksesit ne nivel qendror per produkte te tregut te pergjithshem** (pika 1/b), është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet si më poshtë, por pa u kufizuar:

5.1 Detyrimin e mosdiskriminimit, sipas nenit 39 te ligjit nr. 9918.

5.2 Detyrimin e transparences, sipas nenit 40 te ligjit nr. 9918.

5.3 Detyrimin për akses dhe përdorimin e përbashkët të faciliteteve te rrjetit, sipas nenit 42 te ligjit nr. 9918.

5.4 Detyrimin per kontroll te tarifave sipas nenit 45 te ligjit nr. 9918

6. Detyrimet e mesiperme ne piken 5, perfshijne midis te tjerave:

##### 6.1. **Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)**

1. Altelecom të zbatojë kushte të njëjta, në rrethana të njëjta ndaj sipërmarrësve të tjerë, që ofrojnë shërbime ekuivalente, si dhe t'u ofrojë sipërmarrësve të tjerë shërbime dhe informacion në kushte të njëjta dhe me cilësi të njëjtë, sikundër ai i ofron për shërbimet e veta, për filialet ose partnerët e tij
2. Altelecom të publikojë oferte reference aksesi për bitream në terma jo-diskriminues dhe transparent. Altelecom duhet të perditesoje ofertën referençe të aksesit bitstream, sipas përcaktimeve të këtij vendimi dhe dokumentit të analizës së tregut, përfshirë detyrimin për të dhënë akses bitstream në nivel ethernet në të paktën 12 pika rajonale.

## 6.2. Detyrimi i transparencës (Neni 40)

Oferta Reference e aksesit bitstream e perditësuar sipas pikës 6.1/2 me sipër duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm të nevojshme për ofrimin e shërbimit:

- specifikimet teknike;
- karakteristikat e rrjetit;
- termat dhe kushtet për ofrimin dhe përdorimin;
- tarifën, përfshirë zbritjet e mundshme.

## 6.3. Detyrimi për akses dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)

Altelecom për aksesin me shumicë broadband (bitstream) duhet:

- t'u ofrojë palëve të treta akses në elemente të veçanta të rrjetit dhe/ose faciliteteve, duke përfshirë akses në elemente të rrjetit, të cilat nuk janë aktive
- të mos anulojë aksesin në facilitetet, kur e ka dhënë atë;
- të negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;
- të ofrojë akses të hapur në ndërfaqet teknike, protokollet ose teknologjitë e tjera të rëndësishme, të domosdoshme për ndërveprimin e shërbimeve ose për shërbimet e rrjetit virtual;
- të ofrojë bashkëvendosje ose forma të tjera të përdorimit të përbashkët, përfshirë ndërtesat, tubacionet kabllorë ose shtyllat, kullat;
- të krijojë kushtet e nevojshme për të siguruar ndërveprimin e shërbimeve pikë fundore – pikë fundore, duke përfshirë facilitetet për shërbimet e rrjetit inteligjent;
- të ofrojë akses në sistemet mbështetëse funksionale ose sistemet e ngjashme informatike (*software*), të nevojshme, për të siguruar konkurrencë të ndershme në ofrimin e shërbimeve;

Detyrimi për akses i referohet vetëm për mundësimin e aksesit me shumicë broadband (bitstream) në rrjetin Altelecom, dhe janë të zbatueshme sipas mundësive/aftësive teknike dhe ekonomike të Altelecom, si edhe me tarifën e cilat mbajnë parasysh investimet e kryera dhe një normë të arsyeshme fitimi.

Altelecom ka detyrimin të japë akses me shumicë broadband (bitstream):

- Në nivel ATM/Ethernet;
- Në nivel IP

#### 6.4. Detyrimi per kontroll tarife

1. Tarifat e aksesit bitstream te Albtelecom, jane objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP.
2. Metoda e rregullimit te tarifave te sherbimeve ne piken 1 me siper percaktohet me vendim te vecante nga AKEP sipas percaktimeve te nenit 57 e ne vijim te Ligjit 9918.

7. Sipermarresi ALBTELECOM sh.a. i percaktuar sipermarres me FNT ne **Tregun me shumice te aksesit me cilesi te larte ne vendndodhje fikse** (pika 1/c), eshte i detyruar te zbatoje te gjitha detyrimet si me poshte, por pa u kufizuar:

*7.1 Detyrimin e mosdiskriminimit, sipas nenit 39 te ligjit nr. 9918*

*7.2 Detyrimin e transparencies, sipas nenit 40 te ligjit nr. 9918*

*7.3 Detyrimin per akses dhe interkoneksion dhe perdorimin e perbashket te faciliteteve te rrjetit, sipas nenit 42 te ligjit nr. 9918.*

*7.4 Detyrimin per ofrimin e linjave me qira sipas nenit 44 te ligjit nr. 9918*

*7.5 Detyrimin per kontroll te tarifave dhe sistemin e mbajtjes se llogarive, sipas nenit 45 te ligjit nr. 9918.*

8. Detyrimet e mesiperme ne piken 3, perfshijne midis te tjerave:

##### 8.1 Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39):

- Sipermarresi Albtelecom Sh.a., te zbatoje kushte te njejta, ne rrethana te njejta ndaj sipermarresve te tjerë, qe ofrojne sherbime ekuivalente, si dhe t'u ofrojne sipermarresve te tjerë sherbime dhe informacion ne kushte te njejta dhe me cilësi te njejtë, sikunder ai i ofron per sherbimet e veta, per filialet ose partneret e tij;
- Publikimin e Ofertes Referencë te aksesit ne rrjetin Albtelecom per segmentet terminuese te linjave me qira me shumice, brenda 45 diteve nga hyrja ne fuqi e ketij vendimi. Per ketë pikë Albtelecom do te duhet te zbatoje procedurat dhe rregullat per publikimin dhe permbajtjen e Ofertes Referencë qe jane parashikuar ne Ligj dhe ne rregulloren e Aksesit dhe Interkoneksionit. Oferta Referencë, duhet te permbaje te gjithë termat dhe kushtet e aksesit ne rrjet, perfshire ato te sherbimeve ndihmese, termat dhe kushtet kryesore kontraktuale;
- Sipermarresi Albtelecom Sh.a., te publikoje (si pjesë te Ofertes Referencë) Marrëveshje te Nivelit te Shërbimit (Service Level Agreement-SLA) si dhe Tregues Kryesorë te Performancës (Key Performance Indicators -KPI) per linjat me qira sipas percaktimeve te Rregullores se Akses dhe Interkoneksionit. Marrëveshja e nivelit te shërbimit duhet te mbuloje te gjitha aspektet e rëndësishme te ofrimit te linjave me qira me shumice si kërkesa, porositjen, migrimin, dorëzimin, cilësinë, raportimin, koha e rregullimit te defekteve, dhe kompensime financiare ne rast te mos-realizimit te treguesve te rënë dakort.

##### 8.2 Detyrimi i transparencies:



Oferta Reference e Aksesit të Altelecom për segmentet terminuese të linjave me qira me shumicë duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm të nevojshëm për akses/interkoneksion në linjat me qira të Altelecom:

- a) Specifikimet teknike;
- b) Karakteristikat e rrjetit;
- c) Termat dhe kushtet për ofrimin dhe përdorimin;
- ç) Tarifat, përfshirë zbritjet e mundshme.

### **8.3 Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit:**

**8.3.1** Sipërmarrësi Altelecom Sh.a., për shërbimin e ofrimit të segmenteve terminuese të linjave me qira me shumicë në rrjetin Altelecom, duhet:

- *t'u ofroje palëve të treta akses dhe interkoneksion në rrjet dhe elementet e tij për segmentet terminuese të linjave me qira me shumicë;*
- *te negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;*
- *te ofroje akses të hapur në nderfaqet teknike, protokollet ose teknologjitë e tjera të rendesishme, të domosdoshme për nderveprimin e shërbimeve të linjave me qira;*
- *te interkonektojë rrjetet ose facilitetet e rrjetit për lidhjen e segmenteve terminuese të linjave me qira të Altelecom me rrjetet e operatoreve të tjera.*

**8.3.2** Altelecom sh.a. duhet të japë akses për segmentet terminuese të linjave me qira me shumicë në rrjetin e vet, duke përfshirë:

- *Linja me qira me shumicë (end-to-end): linja të njëjta si linjat e ofruara klienteve fundore;*
- *Qarqe të pjesshme me qira (Leased line partial Circuits): qarqe transmetimi që lidhin një klient fundor të operatorit tjetër me pikën e interkoneksionit të Altelecom me operatorin tjetër si dhe qarqet e transmetimit të ofruar nga Altelecom operatoreve të tjera për tu përdorur në interkoneksionin e ndërmjetëm apo në anën e klientit.*
- *Kapaciteti i linjave të dhëna nga Altelecom do të jetë në varesë të kërkesës së blerësit, duke përfshirë dhe qarqet 34 Mbit/s dhe 155 Mbit/s. Rastet e pamundësive teknike të ofrimit nga Altelecom, do të duhet të justifikohen me shpjegime të plota, bazuar në rregullat dhe procedurat e kuadrit ligjor dhe rregullator (Rregullorja e Aksesit dhe Interkoneksionit);*
- *Linja me qira me shumicë mbi Ethernet në rrjet tradicional dhe/ose NGN;*
- *Akses në linja me qira për lidhje të njëjse të agregimit të linjave lidhëse të MSAN-ve me MSAN-në ku ndodhet Pika fundore e rrjetit (NTU), si shërbim ndihmesë për operatorin që kërkon akses në MSAN për LLU.*

*Për shërbimet e aksesit në Ethernet në rrjetin NGN, Altelecom duhet të perditesojë ofertën referencë të aksesit në çdo rast të ofrimit të shërbimeve me pakicë të kapaciteteve të dedikuara apo me qira, për të mundësuar ofrimin e inputeve ekuivalente për operatorët e tjera me shumicë, në mënyrë që këta operatorë të kenë mundësi ofrimit të shërbimeve që ofron Altelecom me pakicë.*



#### **8.4 Detyrimi për kontroll të tarifave**

1. Tarifat e shërbimeve të linjave me qira me shumice të Albtelecom, janë objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP.
  2. Metoda e rregullimit të tarifave të shërbimeve në piken 1 me sipër përcaktohen me vendim të vecantë nga AKEP sipas përcaktimeve të nenit 57 e në vijim të Ligjit 9918.
- 9.** Afati i vlefshmërisë së statusit me FNT në tregjet përkatës për sipërmarrësin Albtelecom sh.a., është deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër nga AKEP mbi bazën e analizës së tregut të kryer sipas nenit 34 të Ligjit 9918, i ndryshuar.
- 10.** Sipërmarrësi Albtelecom ka detyrimin që të zbatojë detyrime dhe specifikime të tjera të përcaktuara nga AKEP, sipas nevojave të tregut, për statusin e FNT në tregjet përkatës të cituar në këtë vendim.
- 11.** Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me Nr.2415, datë 04.02.2014 dhe Nr.2417, datë 04.02.2014 shfuqizohen. Në përputhje me nenin 34 të ligjit 9918:
- 11.1 Detyrimet e sipërmarrësit Albtelecom sh.a. të përcaktuara në Vendimet Nr.2415, datë 04.02.2014 dhe Nr.2417, datë 04.02.2014, dhe që nuk janë pjesë e këtij vendimi hiqen.
  - 11.2 Heqja e detyrimeve të cituar në piken 11.1 me sipër bëhet efektive 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- 12.** Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R**

**Piro XHIXHO**

#### **ANËTARË:**

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Anila DENAJ**
- 3. Ketrin TOPÇIU**
- 4. Klarina ALLUSHI**